



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

V E N D I M

Nr. 2489, datë 26.06.2014

Për

“Disa ndryshime në Oferten Referencë të Interkoneksionit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Antëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 26.06.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” shqyrtoi çështjen me objekt:

Disa ndryshime në Oferten Referencë të Interkoneksionit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Rregullore nr. 19, datë 14.6.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar;
3. Rregullore Nr. 13 datë 16.04.2010 “Per Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar;
4. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 2176-2179, datë 29.10.2012, për miratimin e ofertave referencë të interkoneksionit të operatorëve celulare;
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP, Nr.2403, datë 26.12.2013, për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a (për rrjetin telefonik fiks).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresë e Altelecom sh.a. me nr. 3544Prot, datë 23.4.2014 (nr. 1083Prot. i AKEP, datë 24.4.2014) Kërkesë për ndërhyrje nga AKEP në lidhje me problematikat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar”;
- Shkresë e Vodafone me Ref. LRD/121/IK, datë 7.5.2014 (nr. 1083/1Prot. i AKEP, datë 9.5.2014) “Në lidhje me kërkesën e Altelecom për ndërhyrje rregullatore në lidhje me terminim e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar”.
- Shkresë e Nisatel sh.p.k. me nr. 101/1Prot. datë 27.5.2014, (nr. 1446Prot. i AKEP, datë 30.5.2014) “Mbi tarifën e terminimit të trafikut ndërkombëtar në rrjetin e Nisatel sh.p.k.”;
- Korrespondenca në formë elektronike e shkëmbyer me AKEP.
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**),

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I. Altelecom sh.a. me anë të shkresës nr. 3544Prot, datë 23.4.2014, ka kërkuar ndërhyrjen e AKEP në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare drejt numrave të portuar në telefoninë e lëvizshme dhe atë fikse.

1. Altelecom shpreh se në lidhje me telefoninë e lëvizshme është i shqetësuar mbi dukurinë e bllokimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar në rrjetin e Altelecom sh.a. dhe për rrjedhojë dështimin e këtyre thirrjeve për pajtimtarin.

Altelecom sjell në vëmendje rastin e Vodafone Albania i cili edhe pse ka MI me Abissnet, refuzon thirrjet nga Abissnet nëse këto thirrje kanë për destinacion një numër Vodafone të portuar në rrjetin Altelecom.

Altelecom shpjegon se nuk ka MI me Operatorin Alternativ (OA) dhe nuk është i detyruar të ketë për shkak të derregullimit të trafikut ndërkombëtar, dhenë këto kushte operatori dhënës është i detyruar të bëjë rrugëzimin e thirrjeve drejt rrjetit tek i cili është portuar numri, që në rastin konkret është Altelecom por mund të jetë edhe cdo operator tjetër mobile sipas rastit që nuk ka MI me OA.

Altelecom shpjegon se edhe pse është përpjekur ta zgjidhë këtë problem në kuadër edhe të detyrimit sipas nenit 7, të Rregullores së Portabilitetit për mbështetjen e rrugëzimit nga të gjithë operatorët, nuk ka arritur një zgjidhje. Kjo i ka krijuar si humbje financiare ashtu edhe ankesa nga pajtimtarët.

Altelecom shpreh se në zbatim të Vendimit të AKEP nr. 2120, datë 4.7.2012, për derregullimin e trafikut ndërkombëtar, dhe në të drejtën e cdo operatori për përzgjedhjen e operatorit me të cilin lidh MI, për trafikun ndërkombëtar, duhet të rishikohet Rregullorja e portabilitetit të numrit dhe ORI e operatorëve si dhe aktet e tjera që rregullojnë këtë proces.

Albtelecom kërkon që në rregulloren e portabilitetit duhet të parashikohet edhe rasti i rrugëzimit indirekt të thirrjeve apo mundësia e rrugëzimit nga operatori dhënës drejt rrjetit të ri ku është vendosur numri.

2. Sa i takon telefonisë fikse, Albtelecom shpjegon se, problematika qëndron tek përcaktimi i tarifës së terminimit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare të origjinuara nga rrjete ndërkombëtare, të përcjella me interkoneksion direkt të Albtelecom me bartës ndërkombëtarë drejt numrave të Albtelecom të portuar në rrjetin e operatorit përfitues.

Precedenti është krijuar nga Nisatel, i cili duke mos patur një MI me Albtelecom për trafikun ndërkombëtar, kërkon të tarifojë Albtelecom sipas tarifës komerciale edhe për thirrjet ndërkombëtare drejt numrave të portuar në rrjetin e tij që Albtelecom rrugëzon drejt rrjetit të operatorit marrës.

Albtelecom shprehet se bazuar në rregulloren e portabilitetit, neni 7, cdo operator ka detyrimin të rrugëzojë drejt rrjeteve të tjera me të cilat jo detyrimisht ka MI për trafikun ndërkombëtar, thirrjet hyrëse ndërkombëtare me destinacion numrat e tij të portuar në rrjete të tjera, thirrje të cilat përcillen nga bartës ndërkombëtarë.

Albtelecom e ka bërë këtë rrugëzim por nga Nisatel ka pretendime për tarifim për terminimin e këtyre thirrjeve si thirrje hyrëse ndërkombëtare në kushtet e derregullimit të këtij trafiku. Albtelecom detyrohet të kryejë rrugëzim të thirrjes dhe po ashtu paguan një tarifë komerciale për një shërbim që e ofron operatori terminues i thirrjes (*Albtelecom i referohet Vendimeve të AKEP nr. 1559, 1560 dhe 1561 të datës 20.4.2011*).

Albtelecom shprehet se ka zbatuar kërkesat e Rregullores së portabilitetit të numrit, VKD nr. 1581, datë 26.4.2011. Në zbatim edhe të MI mes palëve operatorët e kanë faturuar këtë shërbim sipas tarifës së përcaktuar nga AKEP për trafikun kombëtar.

Albtelecom e gjen kërkesën e Nisatel jo në përputhje me kuadrin rregullator por megjithatë për të mos lënë vend për ekuivoke dhe pretendime të metejshme kërkon ndërhyrjen e AKEP për rregullimin e telefonisë fikse në lidhje me tarifimin e thirrjeve ndërkombëtare të përcjella nga bartës ndërkombëtar nga rrjeti dhënës drejt rrjetit marrës të numrit duke bërë përcaktimet edhe në ORI të Albtelecom.

3. Sa më sipër Albtelecom kërkon nga AKEP konsiderimin e ndryshimeve për t'i dhënë një zgjidhje problemit të refuzimit të këtyre thirrjeve dhe dhënies së një shërbimi sa më cilësor pajtimtarit.

II. Vodafone Albania sh.a. me shkresën me Ref. LRD/121/IK, datë 7.5.2014, shprehet se është njohur me kërkesën e Albtelcom dhe pretendimet e tij në lidhje me bllokimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar në Albtelecom.

1. Vodafone sa i takon pretendimeve të Albtelecom, konfirmon se në të gjithë rastet kur trafiku hyrës ndërkombëtar tranzitohet nga operatorë vendas, rrugëzimi i thirrjeve në mënyrën e duhur është detyrim e përgjegjësi rregullatore e operatorëve tranzitues dhe jo e Vodafone, sipas përcaktimeve në Rregulloren e portabilitetit të numrit, neni 7.
2. Vodafone shprehet se të gjithë operatorët, përfshirë edhe OA, në zbatim të Rregullores së portabilitetit, kanë detyrimin që për cdo thirrje pavarësisht se origjinohet nga brenda apo jashtë rrjetit, duhet të aksesojnë CRDB dhe të kryejnë ACQ dhe më pas të dërgojnë thirrjen drejt rrjetit ku pajtimtari ndodhet në atë cast. Për rrjedhojë cdo operator që zbaton

detyrimet rregullatore dhe të Autorizimit të Përgjithshëm, nuk duhet kurrësesi që thirrjet e tij të drejtohen në rrjetin e gabuar ku pajtimtari nuk është më. Ky operator ka detyrimin të terminojë thirrjen në mënyrë korrekte ose ti rrëzojë këto thirrje kur nuk interkonektohet me operatorin përkatës.

3. Vodafone shprehet sa më lart, OA vendas që merr thirrjen ndërkombëtare i pari, drejt numrave Vodafone të portuar në Albtelecom (EM) ka detyrimin ligjore t'i rrugëzojë në rrjetin e Albtelecom dhe jo drejt Vodafone, edhe nëse nuk ka interkoneksion drejtpërdrejtë me Albtelecom, dhe jo ti drejtojë në Vodafone në shkelje të kuadrit rregullator.
4. Vodafone shpjegon se pavarësisht sa më lart, është treguar bashkëpunues duke e ndihmuar Albtelecom, të identifikojë operatorin tranzitues vendas të thirrjeve, edhe pse nuk e ka detyrim rregullator.
5. Vodafone shpjegon se problemi është sic e shpreh vete Albtelecom, se edhe nëse operatori vendas e rrugëzon korrekt thirrjen ndërkombëtare, për sa i takon numrave Vodafone të bartur në Albtelecom, thirrja nuk terminohet se pse Albtelecom ka zgjedhur të bllokojë gjithë trafikun ndërkombëtar të tranzituar, duke mospranuar të lidhë MI me operatorin vendas (si Abissnet).
6. Vodafone shprehet se Albtelecom me propozimin e tij kërkon rregullimin e një tregu tërësisht konkures, sic është tregu i tranzitimit, ku Vodafone nuk ka pse të marrë përsipër detyrime rregullatore.
7. Vodafone shprehet se Albtelecom ka bërë një zgjedhje komerciale duke preferuar të mos lidhë MI për terminimin e trafikut ndërkombëtar me operatorë tranzitues vendas (si Abissnet) ku edhe rrjedhojat që sjell kjo zgjidhje janë komerciale. Kjo nuk mundet të kufizojë lirinë tregtare të operatorëve të tjerë dhe Vodafone.
8. Sa më lart, Vodafone shpjegon se ka mbajtur takime me Albtelecom në ndihmë të zgjidhjes së çështjes.
9. Vodafone shprehet se Albtelecom mund të pranojë terminimin e thirrjeve nga Abissnet, sic vepron me rastet e ngjashme me operatorë mobile, ku nuk ka MI për terminim thirrjesh ndërkombëtare duke përdorur interkoneksionin ekzistues (*sqarojmë senë këtë rast Vodafone ka dhënë edhe shpjegimin teknik për çështjen*).
10. Në përfundim, Vodafone i kërkon AKEP ta trajtojë çështjen në dritën e fakteve dhe argumenteve sa më lart shpjeguar.

III. Sipërmarrësi Nisatel sh.p.k me shkresën nr. 101/1Prot. datë 27.5.2014, (*nr. 1446Prot. i AKEP, datë 30.5.2014*) “Mbi tarifën e terminimit të trafikut ndërkombëtar në rrjetin e Nisatel sh.p.k.” shpjegon se,

1. Albtelecom nuk pranon të paguajë çmimin e vendosur me marrëveshje dhe njoftime dypalëshe, dhe vazhdon të terminojë trafik ndërkombëtar në rrjetin e Nisatel, duke arsyetuar se thirrjet janë kryesisht drejt numrave Albtelecom të portuar në rrjetin e Nisatel, do të mund të tarifohen me tarifë të rregulluar nga AKEP dhe që në marrëveshjet dypalëshe është tarifa e trafikut kombëtar. Albtelecom kërkon që për periudhën prej muajit mars e në vijim, të paguajë 1.5 lekë/min, për një shërbim që duhet të paguajë 18

lekë/min. Ky pretendim i Albtelecom, i shkakton humbje, dhe po e çon Nisatel drejt një situatë financiare që sa vjen e rëndohet duke qenë se Albtelecom vazhdon të dërgojë trafik ndërkombëtar në rrjetin e Nisatel.

2. Albtelecom, i është përgjigjur se ky faturim është bërë me cmim të ndryshëm për trafikun e numrave të portuar nga Albtelecom në Nisatel. Albtelecom pretendon se nuk mund ta devijojë nga ana teknike dhe as ta kthejë mbrapsht me arsyen e duhur tek operatorët ndërkombëtarë që e sjell atë tek Nisatel. Nisatel shprehet se, nga Albtelecom është konfirmuar se i është drejtuar AKEP-it për vendimmarrje dhe për legjitimimin e çmimit të trafikut ndërkombëtar në vlerën e trafikut kombëtar.
3. Nëse AKEP ka hapur procedurat e shqyrtimit të ankesës së Albtelecom, të trajtojë edhe kërkesën e lartpërmendur të Nisatel, si palë e interesuar direkt në vendimmarrje, e cila do të ndikonte për të ruajtur gjendjen aktuale të tregut ose do të nxiste njërën nga palët të përfitojë në kurriz të tjetrës;
4. Nisatel shprehet se AKEP nuk duhet të ndërhyjë dhe të vendosë çmime të rregulluara në një treg të derregulluar të terminimit të trafikut ndërkombëtar, por t'i detyrojë operatorët të marrin masa teknike për rrugëzimin në mënyrën e duhur të thirrjeve pa nxjerrë pretendime absurde me qëllim përfitimin e pandershëm;
5. Vendosja e çmimit të rregulluar për një kategori thirrjesh për terminim ndërkombëtar o vetëm që do të prishë ekuilibrat e tregut por do të lejojë abuzivizëm të madh mes operatorëve, një pjesë e të cilëve nuk ka abonentë 'de facto' por vetëm 'de jure' që vazhdojnë të lëshojnë fatura e të përfitojnë nga operatorët që kanë abonentë.
6. Vendosja e çmimeve të rregulluar për kategorinë e numrave të portuar nuk është as në praktikën e vendeve të BE-së, ku operatorët 'carrier' e rregullojnë me marrëveshje;
7. Krahasimi i situatës me operatorët mobile nuk qëndron sepse këta të fundit shkëmbejnë volum të konsiderueshëm të trafikut ndërkombëtar dhe qarkullojnë sasi shumë të mëdha monetare, sa numrat e portuar të njëri tjetri nuk ndikojnë në vlerat e përgjithshme të trafikut. AKEP është shprehur në qëndrimin e tij se nuk ndërhyr në tregun e derregulluar.
8. Balanca e numrave të portuar Nisatel dhe Albtelecom, është 400 numra të portuar nga Albtelecom në Nisatel, dhe 4 numra të portuar nga Nisatel në Albtelecom. I njëjti raport qëndron mes Albtelecom dhe operatorëve të tjerë alternativë. Nga kjo analizë del përfundimi se i vetmi përfitues nga kjo vendimmarrje e mundshme është Albtelecom, i cili do të përfitonte nga konkurrenca e pandershme, duke forcuar pozitat dominuese në treg, në kurriz të operatorëve alternativë.
9. Vendimmarrja për rregullim të çmimit për trafikun ndërkombëtar do t'i hapte rrugën abuzimeve të mëtejshme, faturimeve fiktive, destabilitetit të tregut dhe falimentimit të operatorëve alternativë, ku të ardhurat nga ky trafik zënë 60 % të të ardhurave nga telefonia. Një vendimmarrje e tillë nga AKEP do ti kalonte Albtelecom-it këtë monopol, si zotërues i pjesës më të madhe të telefonisë në vend, duke vënë në vështirësi operatorët e tjerë.
10. Me këtë vendimmarrje të kërkuar nga Albtelecom, ky i fundit kërkon kthimin mbrapa, duke përdorur justifikim absurd, me qëllim përfitimi. Nisatel kërkon që AKEP të vazhdojë të mos ndërhyjë në një treg të derregulluar si ai i terminimit të trafikut ndërkombëtar, ndërhyrje e cila do të vinte në vështirësi operatorët alternativë.

11. Sa më lart, Nisatel konkludon se Albtelecom është në proces të vetdijshëm të dëmtimit dhe shterrjes ekonomike të operatorëve alternativë dhe tenton me çdo mënyrë dëmtimin dhe pengimin e punës së tyre. Albtelecom kërkon imponimin e rregullave në treg sipas interesave të tij e si i tillë është bërë i rrezikshëm për konkurrencën e lirë dhe dëmtues i qëllimshëm i tregut.
 12. Sa më lart, Nisatel kërkon që AKEP, të mos e marrë parasysh këtë këkesë të Albtelecom, për trajtimin e trafikut ndërkombëtar me të njëjtin çmim me të trafikut kombëtar, veprim i cili bie ndesh jo vetëm me parimet dhe strategjinë e AKEP, por edhe atë të Komunitetit Europian, tregun e lirë dhe konkurrencën e ndershme.
- IV. Nisatel paralelisht më shkresën e cituar më sipër ka dërguar edhe shkresën me nr. 101/2Prot., datë 28.5.2014 (nr. 1447Prot. i AKEP, d atë 30.5.2014) “Kërkesë për fillimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”. Në këtë shkresë Nisatel paraqet argumenta të ngjashme me shkresën e cituar në pikën III më sipër duke kërkuar fillimin e procedurave për zgjidhje mos-marrëveshje me Albtelecom për tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcjella nga Albtelecom drejt Nisatel me destinacion numrat e portuar nga Albtelecom në Nisatel. Kjo kërkesë e Nisatel trajtohet në vendim-marrje të vecantë të AKEP.
- V. AKEP pasi mori në shqyrtim pretendimet e palëve që kanë dhënë mendime për dy çështjet, vlerëson se:
1. AKEP me Vendimet nr. 1559-1561, datë 20.04.2014 dhe me Vendimet 2176-2179, datë 29.10.2012, ka miratuar disa përcaktime/rregulla, të përfshira në ofertat referencë të operatorëve celularë, në lidhje me rrugëzimin dhe tarifën e terminimit për tu aplikuar për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar në rrjete celularë. Sipas këtyre përcaktimeve, **operatori dhënës** celular që merr thirrjen hyrëse ndërkombëtare direkt nga bartës ndërkombëtar (që nuk ushtrojnë aktivitet në Shqipëri pra që nuk janë të autorizuar nga AKEP) **ka detyrimin** të përcjellë thirrjen drejt operatorit marrës celular dhe **operatori marrës ka detyrimin** tëtarifojë për terminimin e këtyre thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar tarifë tënjëjtë me tarifën për terminimin e thirrjeve kombëtare. Këto rregullime janë kryer fillimisht në Prill 2011 me fillimin e implementimit të portabilitetit të numrit celular, me qëllimin e mirëfunksionimit të shërbimeve të portabilitetit dhe mos-humbjes së thirrjeve drejt numrave të portuar. Për thirrjet e origjinuara në Shqipëri nuk ka asnjë problem pasi sipas rregullave të rrugëzimit ACQ operatori origjinues ka detyrimin e kontrollit të bazës së të dhënave të numrave të portuar dhe con thirrjen në rrjetin e duhur. Për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, bartësit ndërkombëtare (të huaj) nuk kanë akses në bazën e të dhënave të numrave të portuar, dhe thirrjet drejt këtyre numrave normalisht i shkojnë operatorit dhënës për shkak të përdorimit të prefiksit të numrave si identifikues i operatorit.
 2. Rregullat e cituara për operatorët celularë përfshijnë detyrime për operatorin dhënës dhemarrës:
 - a. **Operatori dhënës** që merr thirrjet hyrëse ndërkombëtare nga bartës i huaj ndërkombëtar ka detyrim t'i përcjellë këto thirrje drejt operatorit ku është portuar numri;
 - b. **Operatori marrës** ka detyrim të tarifojë për terminimin e këtyre thirrjeve të njëjtën tarifë si edhe për terminimin e thirrjeve kombëtare.

3. Rregullat e mësipërme për operatorët celularë janë përcaktuar në vitin 2011 në kohën që tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare (për marrdhëniet me operatorët tranzitues vendas) ishte nën-rregullim dhe e barabartë me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare. Megjithatë të njëjtat rregulla janë aplikuar edhe pas de-rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, sic mund të vihet re nga përcaktimet e RIO-ve celularë të miratuara më 29.10.2012, në aneksin II, pika 2.4.1, shërbimi 101:

Sherbimi i terminimit të thirrjeve kombëtare të dorezuara nga Operatori Perfitues drejt abonenteve të rrjetit të Vodafone përfshirë:

- a. *thirrje të origjinuara nga abonentët e Operatorit Perfitues;*
- b. *thirrje të gjeneruara nga abonentët e rrjeteve të tjera publike telefonike në Republikën e Shqipërisë dhe që rregullisht janë të tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues*
- c. *thirrje të origjinuara nga rrjete ndërkombëtare, të percjella me interkoneksion direkt tek Operatorit Perfitues me bartes ndërkombëtare (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave të Operatorit Perfitues të portuar në rrjetin e Vodafone.*

Tarifa për të tre llojet e thirrjeve (pra dhe rastin 'c') është e njëjtë sa tarifa nën-rregullim e terminimit të thirrjeve kombëtare. Ky rregullim aplikohet për të dy operatorët celularë palë nënjëmarrëveshje interkoneksioni në mënyrë reciproke.

Objektivi final për këto rregullime ka qenë dhe është që të mos ketë humbje të thirrjeve drejt numrave të portuar, pasi kjo do të dëmtonte portabilitetin si e drejtë e konsumatorit/përdoruesit fundor dhe përfitimet e tij nga shërbimet e komunikimeve elektronike.

4. Këto rregulla kanë funksionuar dhe janë hartuar pas diskutimeve me operatorët. Vodafone është njohur me kërkesën e Albtelecom dhe ka dhënë përgjigje/komente me shkrësë. AKEP më datë 24.06.2014 zhvilloi një takim me katër operatorët celularë për të diskutuar mbi mundësinë e ndryshimeve të mundshme për rrugëzimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar celularë, kur këto thirrje vijnë në Shqipëri përmes një bartësi të thirrjeve ndërkombëtare të autorizuar nga AKEP. Nga diskutimi dy operatorët celularë kërkuan kohë për të dhënë komente me shkrim për kërkesën e Albtelecom. Në këtë mënyrë kjo çështje, për shkak të ndryshimeve të mundshme që mund të prekin RIO-t e katër operatorëve celularë, do të trajtohet pas marrjes së përgjigjeve me shkrim nga operatorët celularë.
5. Në lidhje me tarifën e terminimit për tu aplikuar për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar në rrjete fikse, të percjella nga operatori dhënës tek operatori marrës, ekziston tashmë praktika analoge në rrjetet celularë të përfshira në ofertat referencë të interkoneksionit të operatorëve celularë, të miratuara nga AKEP në Prill 2011 dhe Tetor 2012, të përshkruar në paragrafët e mësipërm.
6. Disa nga arsyt që tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të percjella nga operatori dhënës te operatori marrës të jetë e njëjtë me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare janë:
 - a. Tarifa që operatori dhënës përfiton për terminimin e këtyre thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar (X lek/minutë) është e njëjtë me tarifën e terminimit të thirrjeve drejt numrave jo-të portuar dhe mund të jetë më e ulët se tarifa

- që operatori marrës aplikon për thirrjet hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e vet (Y lek/minutë), dhe në këtë rast operatori dhënës nuk ka interes të përcjellë thirrjet drejt operatorit marrës pasi do të kishte humbje ($Y-X>0$), dhe humbja e thirrjeve drejt numrave të portuar përbën një problem të madh për pajtimtarin e portuar dhe njëkohësisht për procesin e portabilitetit të numrit. Humbja për pajtimtarin e portuar është humbje edhe për operatorin marrës, pasi pakënaqësia e humbjes së thirrjeve hyrëse ndërkombëtare con në pakënaqësi të tij ndaj portabilitetit, operatorit marrës etj.
- b. Operatori dhënës normalisht nuk ka interes komercial të rrugëzojë thirrje drejt numrave të portuar nga rrjeti i tij tek operatori konkurrues, pasi ka humbur një (apo shumë) pajtimtarë drejt konkurrentit dhe në mungesë të detyrimeve rregullatore nuk do ta kryente këtë rrugëzim, me qëllim rimarrjen e këtyre pajtimtarëve. Nëse për këto thirrje tarifa e aplikuar do të ishte më e madhe se tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare (Z lek/minutë) atëherë operatori dhënës nuk do kishte interes rrugëzimin e tyre drejt operatorit marrës.
 - c. Mundësitë teknike apo komerciale që operatori dhënës të kërkojë bartësve ndërkombëtare tarifë terminimi të ndryshme drejt numrave të portuar janë të pakta apo jo-praktike, pasi portimi është një proces i vazhdueshëm që përfshin jo thjesht dy operatorë por më shumë (sidomos në telefoninë fikse).
 - d. Pretendimet se operatori marrës do të humbiste shumë dhe në mënyrë të padrejtë nga diferenca midis tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe kombëtare (Y-Z), duke u bërë përfitim i padrejtë për operatorin dhënës, nuk qëndrojnë pasi:
 - i. AKEP përcakton Z (në nivel të arsyeshëm dhe që aktualisht për OA është më e lartë se për Albtelecom) por tarifa Y dhe diferenca me Z përcaktohet nga operatori marrës dhe jo nga AKEP. De-rregullimi për tarifën e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nuk do të thotë domosdoshmërisht që tarifa Y të jetë shumë më e madhe se Z.
 - ii. Operatori marrës ka përfituar një apo shumë pajtimtarë nga operatori dhënës dhe këta pajtimtarë të rinj për operatorin marrës gjenerojnë normalisht të ardhura shtesë në nivel me pakicë dhe në nivel me shumicë për këtëoperator dhe humbje të të ardhurave për operatorin dhënës në nivel me pakicë dhe me shumicë. Fokusimi për këtë çështje vetëm tek përfitimet/humbjet në nivel me shumicë (në një pjesë të saj) bie në kundërshtim me objektivin e portabilitetit të numrit si e drejtë e pajtimtarit që rrit zgjedhjen e tij dhe konkurrencën në shërbime me pakicë të operatorëve në treg.
 - iii. Nëse nëpërmjet portabilitet të numrave fiks Albtelecom ka humbur shumë pajtimtarë drejt një apo disa operatorëve të tjerë dhe ka marrë shumë pak prej tyre, kjo nuk tregon për rritje të dominancës së Albtelecom, përkundrazi për zvogëlim të saj, pavarësisht se Albtelecom mund të përfitojë ende një sasi të ardhurash nga rrugëzimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar. Gjithsesi edhe përfitimi nga këto tëardhuraështë më i ulët se kur pajtimtari ishte në rrjetin e tij, si dhe Albtelecom ka humbur totalisht të ardhurat nga shërbimet me pakicë dhe terminimi i llojeve të tjera të thirrjeve drejt këtij pajtimtari të larguar nga rrjeti i tij.
7. Në lidhje me komentet se AKEP nuk duhet të ndërhyjë për rregullimin e tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar, pasi tarifa e

terminimit e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është e derregulluar, AKEP gjykon se rregullimi i shërben implementimit efektiv të portabilitetit të numrit dhe është me përfitime për përdoruesit fundore duke krijuar më shumë mundësi zgjedhje për përdoruesit dhe aftësi konkurruese për operatorët më eficientë dhe më të vegjël/hyrës më të vonë në treg se operatori inkumbent.

8. Për sa më sipër, AKEP vlerëson se skema e aplikuar midis operatorëve celular, duhet të aplikohet në mënyrë analoge edhe midis operatorëve të rrjeteve fikse për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar. Ndryshimet do të kryhen duke bërë amendime në ofertat referencë të interkoneksionit të Albtelecom (për rrjet fiks) dhe katër operatorëve celularë. Këto ndryshime i shërbejnë implementimit efektiv të portabilitetit të numrit fiks dhe rritjes të përfitimeve të përdoruesve fundorë nga portabiliteti i numrit dhe konkurrencës së rritur në treg duke minimizuar në maksimum mundësinë për humbje të thirrjeve drejt numrave të portuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Oferta Referencë e Interkoneksionit (ORI) e sipërmarrësit Albtelecom sh.a (për rrjetin telefonik fiks), e miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013, të amendohet si më poshtë:
 - a. Në përshkrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve të dorëzuara **nga** Operatori Përfitues **drejt** përdoruesve (abonenteve) të Rrjetit të Albtelecom, në Aneks 3, dhe në cdo pjesë tjetër të ORI të Albtelecom të lidhur me këtë përshkrim, të shtohet:

Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Operatori Perfitues drejt abonenteve te rrjetit te Albtelecom, perfshire:

- a. *thirrje te origjinuara nga abonentet e Operatorit Perfitues;*
- b. *thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Operatorit Perfitues*
- c. *thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Operatorit Perfitues me bartes nderkombetare (**jo i autorizuar nga AKEP**), drejt numrave te Operatorit Perfitues te portuar ne rrjetin e Albtelecom.*

Tarifa për të tre llojet e trafikut të terminuar në rrjetin Albtelecom është e njëjtë me tarifën përkatëse të terminimit të thirrjeve kombëtare.

- b. Në përshkrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e operatorit përfitues të dorëzuara **nga Albtelecom drejt** përdoruesve (abonenteve) të Rrjetit të operatorit përfitues, në Aneks 3. dhe në cdo pjesë tjetër të ORI të Albtelecom të lidhur me këtë përshkrim, të shtohet:

Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Albtelcom drejt abonenteve te rrjetit te Operatorit perfitues, perfshire:

- a. thirrje te origjinuara nga abonentet e Albtelcom;*
- b. thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republiken e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Albtelcom;*
- c. thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt tek Albtelcom me bartes nderkombetare **(jo i autorizuar nga AKEP)**, drejt numrave te Albtelcomte portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues.*

Tarifa per te tre llojet e trafikut te terminuar ne rrjetin e operatorit perfitues eshte e njejte me tarifën perkatëse të terminimit të thirrjeve kombëtare.

2. Albtelcom sh.a të përditësojë ofertën referencë të interkoneksionit sipas përcaktimeve në pikën 1, brenda 5 ditëve nga data e publikimit të këtij Vendimi.
3. Të njoftohen palët e interesuara për zbatimin e vendimit.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
5. Kundër këtij Vendimi palët e interesuara mund të ankimohen brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit apo publikimit në faqen Web të AKEP.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
PiroXHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE